



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT**

Nr. .... Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

**NJOFTIM PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE TË AGJENCIVE TRAJNUESE PËR  
TRAJNIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË NË SISTEMIN E ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR PRANË KOMISIONIT TË AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE  
TË TRAJNIMIT  
(FAZA 1)**

Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit (KAPT), bazuar në udhëzimin nr.16, datë 28.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” dhe në dokumentin nr. 4186/4 prot, datë 30.08.2021 “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, njofton të gjitha agjencitë trajnuese (përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë) që mbulojnë profilin e mësuesisë dhe që janë të interesuara për të organizuar trajnime me punonjësit arsimorë të sistemit parauniversitar, se **ka hapur procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.**

Aplikimi i agjencive trajnuese për të akredituar programe/module trajnimi **kalon në dy faza:**

- a) Faza e parë është faza e përzgjedhjes paraprake, në të cilën agjencia trajnuese shpreh interesin dhe dorëzon kërkesën e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës.
- b) Faza e dytë është faza kur të gjitha agjencitë trajnuese që kalojnë fazën e parë, dorëzojnë programet/modulet e trajnimit në përputhje me nevojat e punonjësve arsimorë për zhvillim profesional.

**Dokumentacioni i aplikimit të fazës së parë përban:**

- a) Format i aplikimit i plotësuar sipas **shtojcës 2. Bashkëlidhur dokumentacioni juridik dhe CV-të e trajnerëve për çdo modul sipas modelit EUROPASS.**
- b) Lista përmbledhëse për të gjitha modulet (**shtojca 3**).

Tematika e programeve dhe moduleve të trajnimit bazohet në **fushat dhe çështjet kryesore** të paraqitura në dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë, në arsimin parauniversitar për periudhën 2021-2025”.

Në fazën e parë agjencitë trajnuese/IAL-të dorëzojnë kërkesën për aplikim me postë në adresën postare të ASCAP-it, pranë Sekretariatit të KAPT, “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar), Rruga: Naim Frashëri nr. 37”, **brenda datës 04.10.2021.**

**Shënim: Dosjet që dorëzohen mbas kësaj date nuk do të shqyrtohen nga KAPT.**

Agjencitë që aplikojnë mbajnë përgjegjësi për plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të tyre. Për një informacion më të detajuar konsultoni legjislacionin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të ASCAP-it: [www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)

Agjencitë trajnuese që do të kalojnë fazën e parë do të njoftohen për vijimin e procesit të aplikimit të programeve/moduleve të trajnimit në një njoftim të dytë.

Për sqarime specifike lidhur me procesin e aplikimit mund të komunikoni në adresat e email: [sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al); [katsekretariati@gmail.com](mailto:katsekretariati@gmail.com) ose mund të kontaktoni znj. *Gentjana Marku (juriste, ASCAP) me cel: 0693836932*

## **KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT**